



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 07-2008

Prishtinë, më 25 mars 2008, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq, Melihate Tërmkollli Adem Salihaj dhe Džezair Murati.

Të ftuarit: Lumnije Murati-ZPK, Reshit Gashi-NDI, Robert Steere-NCSC.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 11 marsit 2008;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën kontestimore;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën jokontestimore;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën përmbaruese;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për noterinë;
8. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 11 marsit 2008

Kryetari-Pyeti anëtarët për vërejtje eventuale për procesverbalin.

Riza Smaka-Tha se ka vërejtje për procesverbalin. Ai nënvizoi se nuk ka propozuar të shtohet fjala “*vacatio legis*”, por vetëm se ka sqaruar që ligji hyn në fuqi 8 ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare dhe gjithashtu kërkoi të përmendet konflikti administrativ në diskutimin e tij për Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Procesverbali u miratua me vërejtjen e Riza Smakës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë

Për të raportuar për këtë Projektligj ishte caktuar deputeti Kolë Berisha që i paraqiti vërejtjet e veta për Projektligjin. Kolë Berisha i paraqiti propozimet e veta për nenet e Projektligjit. Në bazë të këtyre propozimeve do të hartohet raporti.

Adem Hajdaraj-Theksoi se raportuesi ka bërë një punë shumë të mirë dhe gjithashtu edhe raportuesit e tjerë duhet të vazhdojnë të punojnë kështu. Ai më tutje shtoi se aty ku përmendet: “ish zyrtar”, duhet të shkruhet me vizë, pra “*ish-zyrtar*”. Gjithashtu ai kërkoi që aty ku përmendet “i/e vejë” të ndryshohet me “*vejan / vejushë*”.

Selvije Halimi-U pajtua me parafolësin se mënyra e paraqitjes së raportuesit të sotëm duhet të jetë model edhe për raportuesit e ardhshëm. Ajo nënvizoi se sa u përket gabimeve drejtshkrimore do të bëhet një grup pune që do të merret me përmirësimin e këtyre gabimeve. Ajo i vuri në pah vërejtjet e saj në lidhje me amendamentin 3 të Projektligjit dhe pyeti për kriteret se si matet keqpërdorimi edhe me amendamentin 5 për mbrojtjen e afërt. Ajo propozoi që ministri ta nxjerrë një akt nënligjor për mbrojtjen e afërt.

Bajram Kosumi-Theksoi se e kishte shfrytëzuar këtë të drejtë sipas vendimit të Qeverisë. Ai vuri në pah se ky Projektligj nuk i thekson qëllimet për nxjerrjen e tij. Duhet saktësohet pse ka nevojë për një Projektligj të tillë dhe të sqarohet se me të nuk po themelohet ndonjë institucion i ri. Hartuesi është dashur ta shpjegonte këtë, sepse puna e një ish-kryeministri, ish-kryetari, nuk përfundon për një ditë. Ai nënvizoi se duhet të bëhet një ndarje e të drejtave p.sh.: kryetari i Kosovës gjithmonë mbetet kryetar. Deputeti një herë zgjidhet nga populli dhe e mban të drejtën që në vizitkartë ta shënojë fjalën deputet. Ai propozoi të ndahen të drejtat administrative dhe ato morale. Në nenin 8 të

Projektligjit propozoi të thuhet: “.....t’i sigurohet një vend i respektuar në solemnitete”, jo ndoshta pranë kryeministrit, por të rrijë menjëherë prapa. Ndërsa neni 3.1 të qartësohet me një pasues: “nëse është dënuar nga gjykata e humb këtë të drejtë”.

Riza Smaka-Propozoi që titullit t’i shtohet edhe “Republikës së Kosovës”. Ai propozoi që nga Projektligji të hiqet “kryetari i Gjykatës Supreme”, pasi që ne tash do ta kemi kryetarin e Gjykatës Kushtuese. Te pika 7 e nenit 3, propozoi që edhe fëmijët të kuantifikohen, nëse ka një fëmijë: 70% të bëhet 75%, dy fëmijë 80%, tre fëmijë 85%. Në lidhje me ankesat, deputeti Smaka, vuri në pah se ankesat kanë një afat standard 8 apo 15 ditë dhe jo 30 ditë. Te fjala “institucion përkatës” të tregohet për cilin institucion, për cilën gjykatë është fjala.

Kryetari-Nënvizoi çështjen e qëllimit të ligjit dhe propozoi të hartohet një amendament i ri, më i plotë. Në lidhje me propozimin për një dhe dy fëmijë, propozoi që fare të mos futet në ligj kjo, sepse do ta bënte më të ndërlikuar shqyrtimin e këtij Projektligji në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ai konstatoi se çështja e mbrojtjes duhet të saktësohet se për çfarë mbrojtje bëhet fjalë dhe gjithashtu të saktësohet, pra të shkruhet, me rastin e ankimit se kujt duhet t’i drejtohet pala, cilit institucion ose Gjykatës Supreme.

Riza Smaka-Në fjalën e tij të sërishme theksoi edhe një herë se duhet të hiqet kryetari i Gjykatës Supreme dhe gjithashtu kërkoi që të qartësohet propozim-amendamenti 7, në vend të “marrin pjesë” të bëhet “ftohen”.

Kryetari-Shtoi se duhet të sqarohet edhe propozim-amendamenti 8, “porosi tjetër”, ndërsa në lidhje me propozim-amendamentin 7, propozoi që në vend të “të renditur”, të thuhet “sipas protokollit”.

Kolë Berisha-Sqaroi se është menduar për testamentin, do të thotë vendos me testament.

Idriz Tahiri - Zyrtar i Lartë për Mbështetje të Komisionit, nënvizoi se është më mirë që të mbetet edhe kryetari i Gjykatës Supreme dhe se me mbetjen e Gjykatës Supreme, përfaqësohen që të tri pushtetet: ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori.

Pas diskutimeve për këtë pikë, u vendos që stafi për mbështetjen e Komisionit ta përgatitë formën përfundimtare të amendamenteve sipas diskutimeve dhe propozimeve të miratuara nga anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën kontestimore

Kryetari-Propozoi që për këtë Projektligj të mos caktohet fare raportues, sepse javën që shkoi u mbajt dëgjimi publik. Kërkoi që të gjithë anëtarët e Komisionit t’i sjellin amendamentet e tyre dhe gjithashtu përmes vërejtjeve të dala nga dëgjimi mbetet që javën e ardhshme të amendamentohet edhe Projektligji.

Propozimi u miratua njëzëri.

5. **Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën jokontestimore**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën përmbarese**

Kryetari-Theksoi se më herët është menduar që të organizohen katër dëgjime publike, por për shkak të vëllimit të punës do të jetë vështirë të bëhet një gjë e tillë. Ai propozoi që për Projektligjin për procedurën jokontestimore dhe për Projektligjin për procedurën përmbarese, të mos organizohen dëgjime publike, por për secilin ligj të caktohet nga një raportues dhe nga një ekspert. Ndërsa për Projektligjin për noterinë, të organizohet dëgjim publik në të cilin do të ftohen përfaqësuesit e Odës së Avokatëve, të Gjykatës Supreme, të Fakultetit Juridik, të Shoqatës së Juristëve, të organizatave joqeveritare dhe pas dëgjimit publik të caktohet edhe raportuesi.

Deputetja, **Selvije Halimi**, u propozua që të raportojë për Projektligjin e procedurës jokontestimore, kurse deputeti, **Ramadan Gashi**, u propozua të raportojë për Projektligjin e procedurës përmbarese.

Riza Smaka-Propozoi të ftohen ekspertët për Projektligjin e procedurës jokontestimore dhe për Projektligjin e procedurës përmbarese nga Gjykata Komunale e Prishtinës.

Kryetari-Nënvizoi se brenda këtyre ditëve do të ftohen ekspertët nga Gjykata. Propozoi që dita e mbajtjes së mbledhjes së ardhshme të Komisionit të jetë 1 prilli, ditë e martë ndërsa dëgjimi publik të mbahet më 2 prill, ditën e mërkurë. Ai kërkoi nga stafi mbështetës që t'i përgatitë ftesat dhe materialet.

Pas diskutimit për këto dy pika të rendit të ditës, anëtarët e Komisionit njëzëri miratuan: caktimin e raportuesve për Projektligjet në fjalë dhe caktimin e datës së mbledhjes së ardhshme si dhe të dëgjimit publik. Stafi mbështetës do t'i përgatitë ftesat, materialet dhe organizimin e dëgjimit publik.

7. Të ndryshme

Kryetari-Theksoi se javën e ardhshme, Komisioni do të formojë panelin për intervisitimin e kandidatëve për Avokat të Popullit.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:15.

Procesverbalin e hartoi:
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni